



## Vështrim mbi diplomacinë evropiane kundrejt Shqipërisë në Konferencën e Paqes së Parisit (1946)

MSc. Matilda Voja

### Abstract

This paper aims to address some aspects of European geopolitics towards Albania at the Peace Conference 1946, which includes a broad spectrum of internationally important developments. It focuses on the documented analysis of the circumstances and political and economic factors that conditioned the attitude of the Great Powers of Europe to the Albanian state.

The Great Winning Powers sit on the negotiating table to outline the new post-war international order. For the first time, the two superpowers, the United States and the Soviet Union, built the bipolar system of international relations, dominant in solving European problems. France, though a victorious state, lost its traditional influence in Europe. It emerged economically and morally weakly destroyed by World War II. While Britain, thanks to the island's position and the close ally of the United States, was a powerful voice at big meetings. The fact noted in the decisions of the Yalta Conference (4-11 February 1945) as US diplomatic products by President F. Roosevelt, Soviet Union leader J. Stalin and British Prime Minister W. Churchill.

**Key words:** geopolitics, dominant, political factor, bipolar system.

### Abstrakt

Ky punim synon të trajtojë disa aspekte të gjeopolitikës evropiane ndaj Shqipërisë në Konferencën e Paqes 1946, që përfshin një spektër të gjerë të zhvillimeve me rëndësi ndërkombëtare. Ai përqendrohet në analizën edokumentuar të rrethanave dhe faktorëve politikë e ekonomikë që kushtëzuan qëndrimin e Fuqive të Mëdha të Evropës ndaj shtetit shqiptar.

Fuqitë e Mëdha fituese u ulën në tryezën e bisedimeve për të rivijëzuar rendin e ri ndërkombëtar të pas luftës. Për herë të parë rolin dominues në zgjidhjen e problemeve evropiane e luanin dy superfuqitë e reja, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik, që ndërtuan sistemin bipolar të marrëdhënieve ndërkombëtare. Franca, ndonëse një shtet fitues, e humbi influencën e saj tradicionale në Evropë. Ajo doli e shkatërruar ekonomikisht dhe e dobët moralisht nga Lufta e Dytë Botërore. Ndërsa

Britania, falë pozitës ishullore dhe statusit të aleatit të ngushtë të SHBA-së, ishte një zë i fuqishëm në takimet e të mëdhenjve. Fakt që vërehet në vendimet e Konferencës së Jaltës (4-11 shkurt 1945), si produkte të diplomacisë amerikane të presidentit F. Roosevelt, sovjetike të udhëheqësit J. Stalin dhe asaj britanike të kryeministrit W. Churchill.

**Fjalë kyçe:** gjeopolitikë, dominues, faktor politikë, sistem bipolar.

Roli i Britanisë në ndërtimin e arkitekturës ndërkombëtare të pasluftës ishte determinues në krahasim me shtetet e tjera të Evropës. Prandaj, do të përqendrohemi te analiza e politikës së jashtme britanike, që kishte rëndësi të madhe për orientimin e aleatëve në qëndrimin e tyre ndaj Shqipërisë. Kjo e fundit u rendit përkrah koalicionit Antifashist në luftë kundër okupatorit nazi-fashist, duke mobilizuar të gjitha forcat e sa materiale dhe morale. Por aleatët, në mënyrë të veçantë Britania, nuk e vlerësoi si dhe saduhet sakrificat dhe kontributin e shqiptarëve në lëvizjen e rezistencës kundër Fuqive të Boshtit. Çka u evidentua në politikën e saj jokoherente për çështjen e statusit të Shqipërisë së pasluftës.

Diplomacia angleze ishte rrjedhojë e aleancave dhe e interesave gjeopolitike strategjike të saj në rajon e më gjerë. Për këtë arsye kursi i politikës së jashtme të Britanisë ndaj çështjes shqiptare u kufizua në pohimin a mohimin e marrëveshjeve të ortakërisë. Konkretisht, invadimi italian i Shqipërisë përfaqësonte një ndryshim të statuskuosë në Mesdhe. Kjo ngjarje ishte "në kundërshtim me termat e marrëveshjes, që riafirmonte deklaratën e 2 janarit 1937, në të cilën Britania e Madhe dhe Italia nuk kishin "ndonjë dëshirë të modifikonin ose, përse u takonte atyre, t'a shikonin të modifikuar statuskuonë lidhur me sovranitetin kombëtar të territoreve në "rajonin e Mesdheut"". Përballë këtij fakti, elita politike angleze e dënoi okupimin e Shqipërisë prej fashistëve italianë, duke e konsideruar aktin si shkelje të normave të së drejtës ndërkombëtare. Ajo deklaronte se "çmonte dhe do të mbështeste luftën heroike të popullit shqiptar, se Shqipëria do të ishte përsëri indipendente dhe se Aleatët e Mëdhenj nuk njihnin asgjë nga sa kishte ndodhur në Shqipëri nën urdhërat e pushtuesit pas 7 Prillit 1939".

Gjithashtu, mbështetur në klauzolat e Kartës së Atlan-



tikut, qeveria britanike proklamonte "të drejtën e popujve për të zgjedhur formën e qeverisë nën të cilën ata donin të jetonin dhe shprehte dëshirën që t'u ktheheshin të drejtat sovraane dhe vetëqeverisja atyre popujve që u shtypën me forcë dhe u privuan prej tyre".

Këto deklarata parimore të diplomacisë angleze nuk u aplikuan në rastin e Shqipërisë. Ajo mbajti një qëndrim jo konsekuent për çështjen e statusit, duke u lëkundur midis alternativës së përkrahjes së pavarësisë dhe asaj të çlirimit të Shqipërisë pas lufte.

Kjo ambivalencë termash shprehte influencën e partnerëve të saj në Ballkan dhe besnikërinë ndaj kërkesave të tyre. Në qarqet britanike mbizotëronte ideja se "impikimi për një Shqipëri të pavarur peshonte më tepër se avantazhet e mundshme".

Për rrjedhojë argumentet kundër independencës ishin: 1. gjendja e brendshme e vështirë diktonte

pamundësinë e vetëqeverimit dhe ruajtjes së sovranitetit. "...për shkak të varfërisë së Shqipërisë dhe për paligjshmërinë që propozonte kjo varfëri, dilte se një Shqipëri e plotë, e pavarur do të ishte shkak për turbullira të përvetshme në Ballkan.

Prandaj një shtetshqiptar do të kishte nevojë për mbrojtje dhe udhëheqje. Kjo detyrë mund të merrej përsipër prej një shteti krejtësisht të mosinteresu;

2. independenca e Shqipërisë i hapte rrugë rivendikimeve territoriale të fqinjëve. Sipas përfaqësuesit britanik, Pierion Dixon, "duke njohur pavarësinë ata nxisnin një çerdhe grencash dhe provokonin qeverinë grekedhe jugosllave t'i bënte presion Britanisë për pretendimet e tyre në lidhje me këtë vend".

3. Mirëpo, rrethet diplomatike angleze i rezistuan kërkesave territoriale të Greqisë për Vorio-Epirin dhe të Jugosllavisë për Shqipërinë e Veriut, duke deklaruar se çështja e kufijve të shtetit shqiptar do të merrej në shqyrtim në Konferencën e Paqes. Në përputhje me parimet e moralit politik, Britania kundërshtoi edhe propozimin grek për copëtimin e Shqipërisë mes fqinjit verior e jugor, me kufi në afërsi të Elbasanit.

Në memorandumun e P. Dixon-it "Albania, present attitude of its M.Government", date 30.3.1942, analizohen edhe avantazhet e ripohimit të pavarësisë së Shqipërisë nga Britania e Madhe. Ato ishin të natyrës: a) strategjike, sepse nuk duhej nënvlerësuar kontributi që mund të jepte lëvizja e rezistencës në Shqipëri, zhvillimin e së cilës e lidhnin me shpalljen e deklaratës britanike dhe b) politike, pasi përcaktimi i statusit të Shqipërisë, po të bëhej me kohë, mund të mënjanonte rrezikun që ajo të kthehej në "mollë shëri" midis Jugosllavisë dhe Greqisë.

Më 17 dhjetor 1942, Ministri i Jashtëm britanik, Anthony Eden, shpalli se "Qeveria e Madhërisë së Tij dëshironte ta shihte Shqipërinë të çliruar nga zgjedha italiane dhe pavarësinë e saj të rivendosur. Kjo deklaratë shërbeu si një mbështetje e madhe morale e politike dhe një perspektivë për luftën tonë çlirimtare, ishte një premtim për sigurimin e lirisë dhe të pavarësisë".

Vlerësimi pozitiv i Britanisë për rezistencën antifashiste të popullit shqiptar vërehet edhe në notat e mëvonshme. "Mbas armëpushimit italian, gjermanët kishin zënë në një shkallë të gjerë vendin e italianëve në Shqipëri, dhe ishte evidente që Qeveria Britanike kërkonte

që e gjithë toka shqiptare të ishte e spastruar krejt nga gjermanët. Prandaj ajo priste me gëzim çdo veprim anti-gjerman nga shqiptarët dhe dënonte çdo gjë të një natyre bashkëpunimi shqiptare me gjermanët".

Edhe kryeministri i Britanisë së Madhe, z. Winston Churchill, në fjalën e mbajtur në Dhomën e Komuneve, më 1944, theksonte rëndësinë e qëndrësës së popullit shqiptar kundërokipatorit nazi-fashist dhe kontributin e tyre në operacionet ushtarake të Mesdheut.

Por, në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, autoritetet britanike e ndryshuan përmbytjen e relacioneve diplomatike kundrejt çështjes shqiptare. Ky devijim ishte rrjedhojë e zhvillimeve të brendshme politike dhe orientimeve në politikën e jashtme. Në korrespondencën e personaliteteve politike dhe ushtarake të Britanisë shkruhej se "Shqipëria kishte një rëndësi shumë kalimtare në situatën strategjike të kohës dhe qëllimi i gjeneralit Wilson ishte të caktonte forcat e pakta që kishte në dorë për a) të forcuar Greqinë dhe b) për t'u prerë rrugën gjermanëve në skajin më verior të Adriatikut (Zara, Fiume etj). Gjithashtu, aleatët duhej ta linin Frontin Nacional Çlirimtar të vinte vetë tekata dhe të mos bënin garë me Bashkimin Sovjetik në këtë sektor. Shqiptarët, edhe më pakse Tito, nuk mund ta injoronin zotërimin ushtarak të sovjetëve në Ballkan dhe F.N.Çidoqoftë ishte prosovjetik i deklaruar. Së fundi sjellja mospërfillëse e Hoxhës me oficerët britanikë të ndërlihdjes tregonte qartë qëndrimin e tij, ndaj aleatët nuk do t'i përmirësonin punët për t'i bërë qejfin. Aq më tepër që nuk kishin ndonjë interes britanik për të mbrojtur në Shqipëri ose zotime për të nderuar sikurse në Jugosllavi".

Pas Luftës së Dytë Botërore, Fuqitë e Mëdha e radhitën Shqipërinë në kampin e vendeve fituese. Por, situata e brendshme politike dhe zhvillimet në arenën ndërkombëtare, si ndarja e zonave të influencës në fillimet e Luftës së Ftohtë, kushtëzuan qëndrimin e tyre ndaj shtetit shqiptar. Konkretisht, diplomacia britanike, pas lufte dhe në Konferencën e Paqes në Paris, u konfigurua nga faktorët e mëposhtëm:

Së pari, orientimi politik e ideologjik i Shqipërisë. Ky fakt ndikoi në përpjekjet a) për njohjen ndërkombëtare të qeverisë sonë. Përfaqësues të shteteve demokratike tentuan ta përfshinin Shqipërinë në bllokun Perëndimor. Ata argumentuan përfitimet që buronin nga aderimi në këtë aleancë dhe evidentuan synimet regresive të Bashkimit Sovjetik. Aleatët pohonin se "duheshin bindur u dhëheqësit e F.N.Ç se, për vetë pozitën gjeografiketë Shqipërisë, Rusia nuk do të kishte interes të sinqertë ndaj saj në të ardhmen dhe se ata duhej t'i hidhnin sytë nga Fuqitë e Perëndimit, dhe veçanërisht nga Britania, që të mbronin interesat e Shqipërisë dhe që t'i jepnin ndihmën e nevojshme financiare dhe teknike për zhvillimin e saj". Për më tepër, qarqet politike britanike analizuan përparësitë e njohjes së shpejtë të qeverisë shqiptare në planin e gjerë të zhvillimeve në Ballkan, si parandalimi i një konflikti të mundshëm greko-shqiptar. "

Nëse aleatët vendosnin të mos i përkrahnin pretendimet e Greqisë në Shqipërinë e Jugut, kishte rëndësi që t'i frenonin grekët të mostentonin pushtimin e asaj zone. Ekzistenca e një qeverie shqiptare kompetente e të njohur nga Aleatët e Mëdhenj do të ishte e dobishme



në këtë drejtim”.

Nga ana tjetër, nëkëmbim të njohjes së shtetit shqiptar, Britania nuk do të mjaftohej thjesht me një qëndrim mirënjohës, por do të përpiquej të shkëpuste disa koncesione, si “krijimi i një qeveriepërfaqësuese në vend”. Më 10 nëntor 1945, Britania e Madhe proklamoi njohjen e qeverisë shqiptare me kusht që të organizoheshin zgjedhje të lira dhe të lejoheshin korrespondentët e huaj të raportonin për to. Qeveria britanike caktoi edhe ministrin e saj në Shqipëri, T. C. Rapp, i cili nuk e ushtroi funksionin e tij për shkak të acarimit të marrëdhënieve dypalëshe. Në dallim nga sygerimet e SHBA-së dhe të Britanisë, Franca e njohu qeverinë shqiptare, në dhjetor 1945, dhe dërgoi misionin e saj diplomatik në Tiranë. Parisishfrytëzoi lidhjet tradicionale kulturore dhe frankofone për të zgjeruar marrëdhëniet me Shqipërinë. Por duke i dhënë prioritet interesave ideologjike, qeveria shqiptare nuk ikushtoi vëmendje forcimit të raporteve me Francën. Ajo përfaqësonte të vetmin vend perëndimor që kishte marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë deri në vitin 1949. Konflikti ideologjik midis dy kampeve Lindje – Perëndim u reflektua në vendosjen e sistemit politik, gjendjen e brendshme dhe pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë. Anëtarët e misionit anglez e përshkruanin situatën, si vijon: “Politikën e jashtme e quanin të majtë ekstreme të drejtuar në sferën e influencës ruse, një politikë të adoptuar nga Jugosllavia, një kopje të saj dhe një besnikë të palëkundur të Marshallit Tito dhe të Bashkimit Sovjetik. Ato ishin shprehur hapur në popull kundra politikës duke equajtur pro ruse....Ndërsa për rrethanat e brendshme pohonin: Tiranian e vërtetë në këtë vend, qeverisja me terror, spiunllëku dhe të shtrënguarit e popullit të spiunonin njëri-tjetrin, arrestimet dhe rrahjet në burgjet, gjyqjet e pjekur kundër patriotëve të ndershëm sikriminelë lufte, krimet gjyqësore të njohura si ekzekutime, fallsifikimi i vazhdueshëm i lajmeve dhe i fakteve, zhdukja e së vërtetës dhe e ankimit, donin të thonin se nuk kishte asnjë diferencë midis këtij regjimi dhe fashizmit veçse ky ishte i kuq në vend të atij të ziu”.

Perceptimin negativ të demokracive Perëndimore për organizimin politik të shtetit shqiptar e kishin konstatuar edhe funksionarët e lartë të Partisë Komuniste. Në mbledhjet e zhvilluara, ata deklarorin se Shqipëria nuk përbente një faktor të pavarur në politikën e jashtme dhe përcaktonin masat që duhej të ndërmerreshin në favor të çështjes sonë. Referuar raportit, datë 20 Prill 1946, për pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë, përmendejse “gjendja e vendit ishte e vështirë dhe me të nuk do të mund të mbronin para opinionit botëror të drejtat e tyre si komb e si shtet, prandaj ishte e nevojshme të fillohej menjëherë një punë të madhe jashtë para Konferencës së Paqes. Sepse taktika e armiqve ishte të heshtnin për Shqipërinë, duke injoruar mundësisht edhe ekzistencën e saj, pse kështu mund të bënin çfarë të donin me të, pa u bërë problem në botën e jashtme, kurse shqiptarët duhej të ngrenin problemin e independencës së vendit që të mbroheshin më mirë kundra armiqve”.

Raporti, me një gjuhë propagandistike, paraqiste orientimin politiko-ideologjik drejt Lindjes dhe marrëdhëniet jo të mira me shtetet perëndimore. Këtë pikëpamje

përkrahte edhe Enver Hoxha, në fjalimin e mbajtur me rastin e mbledhjes së dytë të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik, më 7 tetor 1946, ku, ndër të tjera, analizonte peripecitë e procesit të njohjes së qeverisë shqiptare. “Konditat e vëna nga qeveria angleze vetvetiu binin pse karakteri i Regjimit Popullor në Shqipëri dhe ligjet evendimet si dhe aplikimi i tyre bëheshin dhe zbatoheshin në mënyrën më demokratike, kështu që kushtet e vëna nga qeveria britanike vetvetiu u plotësuan”, megjithëse ajo refuzoi të normalizonte marrëdhëniet diplomatike me shtetin shqiptar.

b. Britania dhe aleatët perëndimorë kundërshtuan pjesëmarrjen e Shqipërisë në organizata dhe në konferenca ndërkombëtare. Pas çlirimit të vendit, qeveria shqiptare “kërkoi si një të drejtë legjitime të fituar me gjak e sakrificë që edhe Shqipëria të ftohej në Konferencën e Kombeve të Bashkuara. Shqipëria nuk u thirr në San Francisko me pretekstin se nuk ishte njohur ende qeveria e saj demokratike”.

Në këto kushte, Komiteti Qendror i Partisë i dërgoi një radiogram Sekretarit Politik të Qarkoreve, të cilit i kërkonte organizimin e mitingjeve e manifestimeve, gjoja të dala nga vetë populli, si kundërpërgjigje ndaj qëndrimit të padrejtë të aleatëve, që nuk e ftuan Shqipërinë të merete pjesë në Konferencën e San Franciskos. Në mitingje duhej të theksoheshin përpjekjet dhe lufta e popullit shqiptar krahas gjithë popujve liridashës, si dhe prezantimi i qeverisë si e vetmja përfaqësuese e sovranit.

Në mbledhjen e parë të Asamblesë së OKB-së, që u organizua në Londër, më 10 janar 1946, u refuzua kërkesa e Shqipërisë për t’u pranuar si anëtare.

Me gjithë mbështetjen e delegatit sovjetik dhe të disa vendeve të Lindjes, në sesionin e gushtit 1946, përsëri në Këshillin e Sigurimit, Britania dhe aleatët e saj votuan kundër pranimit të Shqipërisë në OKB. Edhe përpjekjet e qeverisë shqiptare për t’u aprovuar si anëtare e Asamblesë së Këshillit të UNRRA-s u kundërshtuan nga anglo-amerikanët dhe delegate francez, me argumentin se Shqipëria ishte në gjendje lufte me Greqinë.

c. Qëndrimi jomikpritës i qeverisë shqiptare kundrejt Misionit Ushtarak Britanik. Gjenerali Hodgson dhe shumica e oficerëve të Ndërlidhjes mendonin se regjimi i Hoxhës po zhvillohej me një antibritanizëm të fortë dhe pro totalitarizmit rus. Për këtë arsye, “në aktivitetin e tyre politik në Shqipëri ajo që goditën më tepër ishte miqësia jonë me Bashkimin Sovjetik dhe Jugosllavinë, për të cilën miqësi shpreheshin me urrejtjen më të madhe. Në shumë raste gjatë shëtitjeve të anëtarëve të Misionit Anglez në vende të ndryshme të Shqipërisë dhe në lidhje me ndihmat që BS na dërgonte flisnin vazhdimisht dhe e quanin këtë si një mjet që ta pushtonte Shqipërinë jo vetëm politikisht por edhe ekonomikisht. Kurse për marrëdhëniet e mira me Jugosllavinë thoshin se Shqipëria ishte bërë një bisht i Jugosllavisë dhe që qeverisej e punonte me të njëjtën taktikë si ajo”.

Udhëheqja shqiptare ishte skeptike ndaj veprimtarisë politike dhe ideologjike të misionarëve britanikë, e cila nxirrte në pah tiparet jo demokratike dhe mungesën e efektshmërisë së organizimit shtetëror në vend. Kjo diktoi gjithë Komitetet Qarkore të Partisë Komuniste të merrnin masa për të hequr nga qarkullimi çdo mjet të



propagandas së shteteve perëndimore. Në radiogramin dërguar nga Koçi Xoxe, më 12 shkurt 1946, udhëzoheshin "anëtarët e partisë që të kontrollonin dhe të vërenin mirë në çdo anë cilët ishin librarët ose personat që shpërndanin materialin propagandistik anglez dhe amerikan dhe t'i raportonin menjëherë. Me një urdhëresë të posaçme që do të dilte ato ditë nga Ministria e Kulturës asnjë firmë tregtarësh, persona privatë ose organizatë nuk kishte të drejtë të lidhte marrëveshje a kontratë me shoqëri ose librari të shteteve të huaja për të sjellë gazeta, libra etj. përveç Mesagjerisë së Shtypit në Tiranë".

Përpos grumbullimit dhe depozitimit të literaturës dhe organeve të shtypit perëndimor, qeveria shqiptare vendosi rregulla kufizuese që vështirësonin aktivitetin e Misionit Britanik në vend. Konkretisht, "atyre iu mohua e drejta për të udhëtuar lirisht në Shqipëri. Sa herë që donin të shkonin në një vend, një roje e armatosur shqiptare duhej t'i shoqëronte, sikur të ishin rob luftime. Entuziazmi popullor i fillimit u kthye në një armiqësigati të hapur dhe çdo mjet u përdor për t'i mërzhitur dhe bile për t'i poshtëruar. Emri i çdo shqiptari që shkonte të vizitonte ose që takohej publikisht me kryetarët e misioneve britanike dhe amerikane merrej në shënim nga policia e fshehtë dhe ata që pranonin të hynin në shërbim të tyre të ndiqeshin si kriminelë. ...

Komunistët e Tiranës dhunuan rëndë mikëpritjen shqiptare duke urdhëruar misionin britanik të largohej nga Shqipëria".

Në fillim të prillit 1946 u organizua ceremonia e largimit të Misionit Ushtarak Britanik, të cilën udhëheqja komuniste shqiptare e përshkroi me nota ideologjike. "Anëtarët e misionit anglez u vunë në formë autokolone, gjithë makinat që kishin, qysh në mëngjes dhe më vonë u nisën për në Durrës. Kjo mënyrë ikje ishte më tepër në formë demonstrative për të parë popullin se po ikte misioni anglez. Për të inkurajuar reaksionin edhe në momentin e fundit kur po iknin nga Shqipëria, reaksionarët anglezë paraqitnin si një krizë të rëndë në mes të Britanisë dhe Shqipërisë ikjen e misionit, largim i cili do të kushtonte dhe do të kishte konsekuenca të rënda për vendin tonë".

Së dyti, marrëdhëniet shqiptaro-britanike u acaruan për shkak të incidenteve në Kanalin e Korfuzit. Këtu, më 15 maj 1946, dy anije ushtarake britanike "Orion" dhe "Superb" u goditën nga bateritë e rojeve bregdetare shqiptare.

Udhëheqësi Enver Hoxha shpjegoi incidentin me faktin se patrullimi, pa njoftuar i anijeve të huaja, në ujërat territoriale të Shqipërisë përbente një shkelje të rëndë të normave të së drejtës ndërkombëtare. Citoj: "Faji s'ishte aspak i joni për atë ngjarje regretabël po të analizohen rrethanat në të cilat ngjau. Anijet greke me flamur dhe pa flamur, me dhjetëra herë dhe muaj me radhë vinin në ujërat tonë, afroheshin në bregdet, qëllonin me top e me mitraloz, merrnin robër nënshtetas shqiptarë, grabisnin varka dhe bënin njëmijë provokacione të tilla. Bateritë tona dhanë shenjën e largimit dhe masandaj qëlluan me disa të shtëna rrethe për qark. Kur anijet ngritën flamurin anglez ishte tepër vonë. Kurrë nuk ishte intension i komandës sonë bregdetare të qëllonte anijet e Britanisë së Madhe".

Mirëpo, ashpërsimi i marrëdhënieve midis dy vendeve ar-

riti kulmin me një tjetër ngjarje të rëndë në Kanalin e Korfuzit. Më 22 tetor 1946, kryqëzori britanik Saumarez dhe destroyeri Voyage, ndeshën në mina detare, nga shpërthimi i të cilave humbën jetën 44 marinarë dhe dhjetëra të tjerë u plagosën. Qeveria shqiptare shprehu keqardhje për incidentin, por nuk pranoi kurrfarë përgjegjësie. Ky qëndrim i autoriteteve shqiptare shkaktoi pakënaqësi të thellë në qarqet e diplomacisë angleze, e cila me një notë zyrtare njoftoi fillimin e një operacioni minapastrues përgjatë bregdetit tonë. Si kundërpërgjigje, më 13 nëntor 1946, qeveria shqiptare i dërgoi një telegram Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Trygve Li, me anën e të cilit protestohej kundër shkeljes së ujërave territoriale të vendit nga forcat ushtarake-detare të Britanisë, si vijon: "Qysh më 12 nëntor në mëngjes një numër i madh anijesh luftime me flamurin anglez përshkruan në të gjithadrejtimet bregun tonë të jugut të Shqipërisë, që nga Butrinti deri në Karaburun. Të gjitha anijet angleze në formacion luftime lundronin në ujërat tona territoriale dhe extra-territoriale në shenjë frikësimi dhe provokimi. Sot, më 13 nëntor 1946, në orën 10 të mëngjesit dhe gjatë gjithë ditës, një numër i madh anijesh luftime dhe dragaminash angleze, numër që ndryshonte në çdo orë nga 11 deri në 23, hynë në ujërat tona territoriale të Sarandës në një largësi prej 1500, 1000, 500 m nga porti me pretekst se pastronin minat. Nga anijet e luftës angleze, në çdo kohë, shkreheshin batara mitralozash në ajër dhe në ujë, duke dashur kështu të krijonin incidente. Qeveria shqiptare kërkonte nga OKB-ja që ta gjykonte këtë akt të Londrës dhe të jepte urdhërin e tërheqjes imediate të anijeve të luftës dhe të dragaminave angleze nga limanet dhe nga ujërat tona territoriale, në interesin e ruajtjes së paqes, për të cilën populli shqiptar vuri të gjitha forcat për ta fituar".

Megjithë polemikat që shkaktoi në instancat më të larta ndërkombëtare, nëntë luftanije britanike kryen operacionin minapastrues, që përfundoi me gjetjen e 22 minave të prodhuara në Gjermani. "Vëzhguesit e paanëshëm, që u ndodhën prezent, panë vet me sy se metali i minave dhe i kabllot që i lidhte për mos të lëvizur prej vendit shkëlqente prej vajit dhe kjo ishte prova më e mirë se minat kishin qenë në ujë për një kohë të shkurtër. Ky fakt i dha arsye Ministrisë së Jashtme britanike për të thënë se minat që shkaktuan prishjen e dy luftanijeve ishin vënë në ujërat tokësore të Shqipërisë në kohën e qeverisë komuniste të Tiranës dhe pra me dijeninë e saj të plotë. Kjo ishte një shkelje shumë serioze e ligjit ndërkombëtar, për të cilën qeveria komuniste ishte përgjegjëse".

Në këto kushte, Britania, nëpërmjet një note zyrtare, i kërkonte qeverisë shqiptare të lypte ndjesë publike sipas formulës tradicionale, të garantonte mospërsëritjen e incidenteve të tilla, të paguante dëmshpërblim për anijet e shkatërruara dhe të kompensonte familjet e viktimave. Më 21 dhjetor 1946, autoritetet shqiptare iu përgjigjën notës britanike, duke hedhur poshtë çdo akuzë dhe kërkesë për dëmshpërblim.

Tonet konfliktuale në korrespondencën diplomatike diktauan Britaninë që, më 10 janar 1947, t'i kërkonte Këshillit të Sigurimit të OKB-së shqyrtimin e mosmarrëveshjeve shqiptaro-britanike, për ngjarjet në Kanalin e Korfuzit, në bazë të artikullit 35 të Kartës.

Çështja përfundoi në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës,



që me vendimin e marrë, më 9 tetor 1949, shpallte Shqipërinë fajtoare për incidentin dhe e detyronte të likuidonte reparacionet. Dëmshtëpërlimi u shlye "me sekuestrimin nga anglezët në Gjermani të një sasie ari që ishte grabitur prej gjermanëve në Romë e që kishte qenë për llogari të Bankës Kombëtare Shqiptare. Pak kohë më vonë një pjesë e këtij ari, natyrisht iu kthye Shqipërisë nga një komision tripartitësh amerikano-britaniko-francez".

Në kontekstin e Luftës së Ftohtë, ngjarja e 22 tetorit 1946, nuk erdhi si "incidentrastësor", por si epilog i Konferencës së Paqes në Paris, ku u prekën interesat e Shqipërisë dhe jugosllavët si gjithmonë "të shkathët" në këto çështje, e "ndihmuan" Shqipërinë të hakmerrej me lejen apo dijeninë e saj për t'i hedhur në erë anijet armike ndaj bllokut lindor".

Në fakt, incidenti i 22 tetorit 1946 ishte një çështje e ndërlikuar e me fajësi të dyanshme. Qeveria shqiptare kishte lejuar jugosllavët të minonin ujërat e saj territoriale në Kanalin e Korfuzit. Për të, vendosja e minave shërbente si një masë mbrojtëse nga ndonjë agresion i mundshëm prej jugut, në rrethanat e acarimit të marrëdhënieve me Greqinë. Nga ana tjetër, "qeveria britanike e provokoi incidentin me dërgimin e anijeve ushtarake në pjesën veriore të Kanalit të Korfuzit. Ky incident mbeti një hipotezë e rëndë në marrëdhëniet midis dy vendeve për gjysmë shekulli".

Së treti, interesat gjeopolitike të Britanisë në Ballkan e më gjerë diktuan triumfin e diplomacisë së ortakërisë, ku rol të rëndësishëm kishte marrëdhënia miqësore me Greqinë. Kjo e fundit shërbeu si bazë për politikën antikomuniste të kampit Perëndimor gjatë Luftës së Ftohtë. Ajo u shfrytëzua si kundërpeshë ndaj qeverive të ashtuquajtura të demokracive popullore, që u vendosën në bllokun Lindor. Për më tepër, pozita e favorshme gjeografike e Greqisë u përdor për mbajtjen nën kontroll të Detit Mesdhe.

Britania e Madhe, duke ndikuar mbi veprimet greke, kishte mundësi të dominonte daljen në Adriatik dhe, duke patur një tjetër Gjilbraltar në një nga këto porte, ajo kishte nën kontroll pozitën e Jugosllavisë në detin Adriatik. Pjesën perëndimore të tij, Britania mund ta zotëronte me drejtimin e përkohshëm të politikës së jashtme italiane, ndërsa anën lindore me sovranitetin grek mbi Shqipërinë e jugut. Kështu Londra, duke kontrolluar daljen e Adriatikut, mbikëqyrte Jugosllavinë dhe ndonjë ekspansion të mundshëm sovjetik.

Qeveria greke e shfrytëzoi bashkëpunimin me Britaninë për të siguruar mbështetje në realizimin e qëllimeve të saj. Për aneksimin e Vorio-Epirit, Athina zyrtare argumentonte: "Zotërimi i këtij bregdeti [të Sarandës, të Himarës dhe të Vlorës - E.L], qëdominonte ngushticën e Otrantos përbënte në Mesdheun Lindor, një pikë strategjike me rëndësi dhe pikërisht mbi udhëkryqin që ndante Lindjen nga Perëndimi. Kjo vijë mbartte një rëndësi të madhe për sundimin britanik të Lindjes së Afërme".

Përpos lobimit në qarqet diplomatike angleze, autoritetet greke paraqitën pretendimet e vjetra të "Megali Idhesë" për Shqipërinë e Jugut edhe në forume të larta ndërkombëtare. Kërkesat e tyre territoriale ishin jetike për qëndrueshmërinë politike dhe ekonomike të Shqipërisë si shtet i pavarur dhe përbënin afërsisht çerekun

e sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Qeveria shqiptare i konsideronte thëllësisht të pa baza pretendimet greke, duke paraqitur fakte të pakontestueshme historike, etnike dhe demografike. Ajo vuri në dispozicion të delegatëve pjesëmarrës në Konferencën e Paqes edhe disa materiale që përmbanin pasqyra të regjistrimit të popullsisë në Shqipërinë e Jugut.

Thirrjeve të kryeministrit grek, z. Caldaris, për rivendikimin e Epirit të Veriut, delegacioni shqiptar iu kundërpërgjigj se ishte e pa vend dhe një gjë e papranueshme të prekej në këtë Konferencë çështja e integritetit tokësor të Shqipërisë. Populli shqiptar i vogël në numër, por i madh nga sakrificat që kishte bërë për kauzën e përbashkët, nuk ndodhej aty për të diskutuar për kufijtë e tij, por për të shprehur dhe për të kërkuar të drejtat e veta. Ata deklarorin solemnisht se brenda kufijve ekzistues nuk kishte asnjë pëllëmbë tokë të huaj dhe nuk do të lejonin kurrë që t'ua preknin, sepse për to ishin të shenjta.

Mirëpo, z. Caldaris nuk u pengua nga deklaratat e delegatëve shqiptarë që të vazhdonte të insistonte për aneksimin e Shqipërisë së Jugut, duke argumentuar, ndër të tjera, nevojën e një kufiri mbrojtës me fqinj verior. Për këtë qëllim i shërbente "gjendja e luftës me shtetin shqiptar". Retorikën politike të kryeministrit grek e kundërshtonte E. Hoxha në fjalimin e mbajtur, në seancën plenare të Konferencës së Paqes në Paris, më 21 gusht 1946, teksa shprehej: "Populli shqiptar flak te poshtë me përbuzje akuzën poshtëruese të delegatit grek, që e padiste vendin si sulmues. Populli shqiptar nuk e kishte sulmuar kurrë popullin e ndershëm grek, nuk i kishte shpallur kurrë luftë. Përkundrazi, e kishte simpatizuar kauzën e tij që ishte njëkohësisht dhe kauza e popullit shqiptar, sepse që të dy popujt kishin pësuar të njëjtin fat, duke qenë se kishin të bënin me të njëjtin armik".

Autoritetet zyrtare greke e shfrytëzuan "gjendjen e luftës me Shqipërinë" si mjet për të arritur synimet e tyre aneksoniste. Në fakt ligji 2636/1940, me të cilin Greqia deklaronte Shqipërinë si një vend armik përbënte një akt të pajustificuar juridikisht, politikisht dhe moralisht. Pasi nuk mund të konsiderohej armik një shtet i pushtuar, që nën imponimin e pushtuesit i shpallte luftë një shteti tjetër, sidomos sepse i mungonte l'animus bellandi (vullneti për luftë).

Përpos këtyre përpjekjeve të delegacionit grek për të zbehur kontributin e Shqipërisë në luftë kundër Fuqive të Boshtit, përkrah Aleancës Antifashiste, ambasadori grek Vassili Dendramis, kërkonte pjesëmarrjen e Greqisë në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në gusht 1946, për të influencuar delegatin britanik, Sir Alexander Cadogan, të refuzonte pranimin e Shqipërisë si anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Faktorët e sipërpërmendur ndikuan në një masë të konsiderueshme në qëndrimin e Britanisë ndaj çështjes shqiptare gjatë punimeve të Konferencës së Paqes së Parisit (29 korrik - 15 tetor 1946) dhe në instancat ndërkombëtare të krijuara prej saj.

Nëpërmjet kanaleve diplomatike, Fuqive të Mëdha iu komunikua kërkesa e qeverisë shqiptare për të marrë pjesë në Konferencë, me qëllim që të bashkëpunonte me shtetet demokratike për ndërtimin e paqes dhe të sigurisë në arenën ndërkombëtare. Në cilësinë e palës së interesuar,



ajo e vlerësonte të domosdoshme të parashtronte pikë-pamjete saj mbi të gjitha çështjet që përkonin me Traktatet e Paqes.

Me kundërshtimin e delegacioneve anglo-amerikane dhe të satelitëve të tyre, Shqipëria nuk u pranua me votë konsultative në sesionet e Konferencës, por iu dha drejta të dëgjohej vetëm në lidhje me Traktatin e Paqes me Italinë. Ky vendim nuk u mirëprit nga qeveria shqiptare, e cila e quajti një shpërblim jo të drejtë për kontributin e dhënë në Luftës së Dytë Botërore. "Populli shqiptar që rroku i pari armët kundër fashistëve italianë, që rendnin me urë në dorë për t'i vënë zjarrin Evropës dhe që pushoiluftën vetëm kur u mposht Gjermania hitleriane, meritonte një drejtësi më të madhe. ...ai e kishte fituar me luftë të drejtën të merre pjesë në këtë konferencë, me titull dhe me të drejta të njëjta më ato të 21 kombeve fitimtare".

Qëndrimi jo miqësor i aleatëve ishte një sinjal i qartë për mosaprovimin e politikës së brendshme dhe të jashtme të Tiranës, që do të reflektohej edhe në diskutimet për çështjen shqiptare. Konkretisht, në Komisionin Ushtarak, delegacioni shqiptar paraqiti disa amendamente që synonin reduktimin e armatimeve, me qëllim që flota dhe ushtria italiane të mos përbënte rrezik kërcënimi për ekzistencën e Shqipërisë dhe paqen në rajon. "Meqë populli shqiptar ishte viktimë e parë e agresionit fashist në Evropë dhe duke marrë parasysh nevojën urdhëruese të Shqipërisë që të kishte një flotë të vogël dhe të përshtatshme për të mbuluar ujërat e saj territoriale, qeveria shqiptare mendonte se do të ishte e drejtë dhe e udhës që, kur të vendosej mbi fatin e flotës italiane, të merreshin parasysh konsideratat e lartpërmendura dhe t'i caktohej Shqipërisë një pjesë e arsyeshme dhe proporcionale me nevojat e mbrojtjes detare të vendit". Por, në kundërshtim me propozimet e palës shqiptare, delegacioni britanik ia dhuroi shtetit Italian pjesën që i takonte nga ndarja e flotës.

Të njëjtin qëndrim mbajti përfaqësuesi britanik edhe ndaj kërkesave shqiptare në Komisionin Ekonomik. Ai mohoi të drejtën për dëmshpërblime nga Italia, duke argumen-

tuar se qeveria shqiptare kishte shtetëzuar pasuritë italiane. Kompromisi për problemin e reparacioneve u arrit me propozimin e shumë prej 5 milionë \$ nga delegatë francez, në nëntor 1946, në sesionin e New York-ut të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme.

Përsa i përket diskutimit të Traktatit të Paqes me Gjermaninë, qeveria shqiptare deklaronte se e mbështeste politikën e saj: "në principet që lindën nga lufta kundër fashizmit e që ishin vënë në krye të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Edhe në periudhën e re paqësore që kishte filluar pas fitores, ajo konsideronte si një pikë bazë për ruajtjen e forcimit të paqes e të sigurisë kolektive marrëveshjen e plotë midis Fuqive të Mëdha rreth problemeve kryesore të paqes e të sigurisë". Referuar çështjes së dëmshpërblimeve nga Gjermania, shteti shqiptar u bë anëtar i Agjencisë Ndërraleate të Reparacioneve. Në kategorinë "A" pjesa që ai do të merre ishte e barabartë me 1/2000 e sasisë së përgjithshme të reparacioneve të kësaj kategorie, kurse në kategorinë "B" 7/2000. Megjithatë edhe pse jashtëzakonisht të vogla, ato nuk u realizuan. Komisioni Shtetëror i Reparacioneve, i ngritur pranë Komisionit të Planit të Shtetit, pohonte se organizmat e IARA-s i atribuon Shqipërisë një sasi simbolike materialesh, të cilat në shumë raste, me pretekste të çfarëdoshme nuk u dhanë apo nuk mbërritën në destinacion. Për të konkluduar, vlen të theksojmë se qëndrimi i Britanisë në Konferencën e Paqes dhe në instancat derivate të saj nuk u konsiderua i drejtë dhe parimor nga qeveria shqiptare e kohës. Pozicionimi në kampe antagonistë në fillim të Luftës së Ftohtë dhe organizimi i brendshëm politik i Shqipërisë ndikuan lojën diplomatike të delegacionit britanik. Ky i fundit nuk i vlerësoi në mënyrë objektive sakrificat dhe kontributin e popullit shqiptar në luftë kundër okupatorit nazi-fashist, përkrah Aleatëve të Mëdhenj. Fakte këto që konsakrohen me nënshkrimin e Traktateve të Paqes me Italinë dhe Gjermaninë. Për rrjedhojë, mungesa e frymës së bashkëpunimit mes kombeve pengoi arritjen e paqes demokratike në arenën ndërkombëtare.

## Referime bibliografike

Ahmetaj, Lavdosh. "Shqipëria në Konferencën e Paqes së Parisit", Gjurmime albanologjike - seria e shkencave historike 36-2006, Prishtinë, 2007

Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Historia e popullit shqiptar, vëll. 2. Tiranë: Toena, 2002

Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Historia e popullit shqiptar, vëll. 3. Tiranë: Toena, 2007

Baça, Ferit F. Shqipëria dhe organizatat ndërkombëtare. Tiranë: Globus, 2010

Bakalli-Arifi, Emine. Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare. Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011

Bashkurti, Lisen. Diplomacia shqiptare në fillimet e "Luftës së Ftohtë" 1945-1961: nga

Konferenca e Jaltës tek "bashkekzistenca paqësore". Tiranë: Geer, 200

Bashkurti, Lisen. Diplomacia shqiptare, vëll 1. Tiranë: Geer, 2005

Bashkurti, Lisen. Shqiptarët në rrjedhat e diplomacisë: nga "universalizmi" tek "lufta e ftohtë". Tiranë: Geer, 2003